



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministrit të Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 15 /2026

Datë: 30.01.2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019) dhe neni 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me shtojcën 1, (pika 3) të Rregullore (QRK) - Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, duke u bazuar në nenin 371 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (Gazeta Zyrtare nr. 3/2013, 31.01.2013), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (Gazeta Zyrtare nr. 15/2017, 11.05.2017), si dhe bazuar në nenin 5 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MD-NR. 09/2014 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbartuesit Privat, Ushtruesi i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. PRANOHET kërkesa e av. Florim Vertopi, për përjashtim e zëvendës anëtarit të Komisionit Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat, Shermet Livoreka, i emëruar sipas vendimit të Ministres nr. 351/2025 dt. 01.08.2025, në rastin disiplinor: DPSDPLS.nr.19/2025, të iniciuar nga z. Mehdi Reshani, Kryetar i Odës së Përmbartuesve Privat ndaj Përmbartuesit Privat z. Isak Islami, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.
2. AUTORIZOHET Përmbartuesi Privat z. Gjokë Radi i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë që si anëtar ad-hoc i Komisionit Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat, të vendos në rastin disiplinor DPSDPLS.nr.19/2025, të iniciuar nga z. Mehdi Reshani, Kryetar i Odës së Përmbartuesve Privat ndaj Përmbartuesit Privat z. Isak Islami, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe aplikohet vetëm për rastin disiplinor DPSDPLS.nr.19/2025.
4. Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

Arsyetim

Z. Florim Vertopi përfaqësues i autorizuar i përmbaruesit privat Isak Islami, në seancën dëgjimore të dt.17.11.2025 ka kërkuar përjashtimin e anëtarit të Komisionit Driton Govori, me arsyetim se dispozita e nenit 371 e LPP-së përcakton përjashtimin, po ashtu edhe neni 5 i Udhëzimit administrativ për procedura disiplinore 09/2014 që konkretisht që të dyja e potencojnë se në këtë rast vlejnë dispozitat e procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarit. Tutje ka shtuar se nga këto baza përjashtimin e mbështesim edhe në nenin 67 pika a) dhe g) të LPK-së . Në fakt, Driton Govori në këtë rast është palë në procedure dhe ka konflikt interesi që të jetë anëtar i këtij Komisioni Disiplinor. Driton Govori është nënkryetar i Odës së Përmbaruesve Privat dhe po ashtu anëtarë i bordit të Odës së Përmbaruesve Privat.

Me datën 23.12.2025 me Vendimin nr. 437/2025 pranohet kërkesa e Z. Florim Vertopi përfaqësues i autorizuar i përmbaruesit privat Isak Islami dhe autorizohet zëvendës anëtar i Komisionit Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat Shermet Livoreka i emëruar sipas vendimit të Ministres nr. 351/2025 të datës 01.08.2025 për vendosje në rastin disiplinor DPSDPLS.nr. 19/2025 të iniciuar nga z. Mehdi Reshani, Kryetar i Odës së Përmbaruesve Privat ndaj Përmbaruesit Privat z. Isak Islami i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat e mbajtur me datën 16.01.2026 në përbërje Naim Mehulli, kryesues, Ramush Bardiqi, anëtar dhe Shermet Livoreka zëvendës anëtar, në rastin disiplinor DPSDPLS.nr. 19/2025 ndaj përmbaruesit privat z. Isak Islami, përfaqësuesi i autorizuar i Përmbaruesit Privat z. Florin Vertopi ka kërkuar përjashtimin e zëvendës anëtarit të Komisionit Sheremet Livoreka, me arsyetim se Sheremet Livoreka është anëtar i bordit të Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës. Bordi është organ esencial dhe në rang më i fuqishmi pas Kuvendit të Odës së Përmbaruesve Privat. Sheremet Livoreka është anëtar i Bordit dhe i njëjti ka ndërmarr veprime konkrete. Prandaj kërkon nga Ministri i Drejtësisë që në bazë të nenit 67 pika a) dhe b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe nenit 371 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 5 UA -MD 09/2014, të merr vendim dhe të pranoj në tërësi propozimin e tyre duke përjashtuar nga vendosja në këtë komision disiplinor sepse nga provat e paraqitura përpos që është vërtetuar se Sheremet Livoreka është palë në këtë procedurë i njëjti është edhe subjekt i drejtpërdrejt i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit. I autorizuari i Përmbaruesit Privat deklaroi se pranimi i kërkesës së tyre për përjashtimin e zëvendës anëtarit të Komisionit Disiplinor z. Livoreka do të kontribuonte gjykimit të paanshëm dhe të drejtë si dhe do të ruante integritetin e Ministrisë së Drejtësisë.

Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë pasi shqyrtoj kërkesën dhe Procesverbalin duke i analizuar në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore gjeti se kërkesa është e bazuar dhe vlerëson se përjashtimi i zëvendës anëtarit të Komisionit Disiplinor në lidhje me këtë rast do të ndikoj pozitivisht në rritjen e besimit të palët për objektivitetin e Komisionit Disiplinor ashtu që konform nenit 370 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 kërkoj nga Oda e Përmbaruesve Privat të propozoj Përmbaruesin Privat që do të jetë anëtar ad-hoc në Komisionin Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat dhe i cili do të vendos vetëm për rastin Disiplinor DPSDPLS.nr. 19/2025.

Andaj bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Blerim SALLAHU
Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kryesuesit dhe Anëtarëve të Komisionit;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Përmbaruesit Privat;
- Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;
- Odës së Përmbaruesve Privat;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.